



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:085625
Datë: 25.03.2025
Numri i dokumentit: 07038154

CN.23/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Ardian Ajvazi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses V. B. nga Sh., kundër të paditurës Komuna e Shtërpcës, të cilën e përfaqëson Dragan Veljkovic, avokat nga Shtërpca, me objekt kontesti kompensimi në emër të shujtës ditore, vlera e kontestit 1.432.00 euro, duke vendosur sipas propozimit të autorizuarit të të paditurës për përsëritje të procedurës së përfunduar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj Dega në Shtërpcë Departamenti i Përgjithshëm C.nr.86/2021, të datës 10.08.2021, jashtë seancës me datë **25.03.2025**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET SI I PABAZUAR Propozimi i të paditurës Komuna e Shtërpcës për Përsëritjen e Procedurës në kontestin e përfunduar me Aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Ferizaj Dega në Shtërpcë Departamenti i Përgjithshëm C.nr.86/2021, të datës 10.08.2021.

A r s y e t i m i

Propozuesja, përmes të autorizuarit të saj, me datë 11.11.2021, në Gjykatën Themelore në Ferizaj- Dega në Shtërpcë ka paraqitur propozim për përsëritje të procedurës kontestimore, me propozim që të lejohet përsëritja e procedurës në çështjen juridike civile C.nr.86/2021 dhe të anulohet Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Ferizaj-Dega në Shtëpcë C.nr.86/2021, i datës 10.08.2021.

Në propozim ndër të tjera ka cekur se përmes aktgjykimit të formës së prerë C.Nr.86/2021 të datës 10.08.2021 është detyruar e paditura që paditëses t'ia paguajë kompensimin për shpenzimet e ushqimit në vlerë prej 1,288.00 €, për periudhën prej 1.01.2018 deri më 1.04.2018 me kamatën ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë deti në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në vlerë prej 30,00 €, në afat prej 7 ditësh nga data e pranimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit.

Pasi që aktgjykimi është bërë i formës së prerë, gjegjësisht më 18.10.2021, Gjykata e Apelit e Kosovës, me qëllim të unifikimit të praktikës gjyqësore, me shumicë votash konstatoi se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive ka qenë në fuqi deri më 31.12.2017 dhe se nuk mund të zbatohet pas kësaj date. Propozuesi thekson se po të ekzistonte ky konkluzion në kohën e zhvillimit të procedurës para gjykatës së shkallës së parë dhe nëse i padituri do të kishte mundur

të përdorte të njëjtin epilogu i çështjes C.nr.86/2021 të datës 10.08.2021 do të ishte krejt ndryshe dhe më i favorshëm për të paditurin pasi baza ligjore për miratimin e pjesëshëm të padisë së paditësit ishte pikërisht Kontrata e Përgjithshme Kolektive. Andaj, propozuesi konsideron se janë plotësuar kushtet për përsëritjen e procedurës sipas nenit 232, pika g e LPK-së, me propozimin që të aprovohet kërkesa për përsëritjen e procedurës dhe të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Shtërpcë C.nr. 86/21 e datës 02.08.2021.

Paditësja nuk kanë parashtruar përgjigje me shkrim në lidhje me këtë propozim.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit në kuptim të nenit 235 dhe 239.1 të LPK-së, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të propozimit për përsëritjen e procedurës së parashtruar nga pala e paditur dhe shkresave tjera të lëndës gjeti se:

- Propozimi për përsëritjen e procedurës është i pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja kundër të paditurës ka ushtruar padi për kompensimin e ushqimit në punë-shujtave ditore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor dhe pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse ka vendosur që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar, ashtu si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Ndërsa në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ndër të tjera konstaton se nuk është kontestues fakti se paditësja është e punësuar tek e paditura dhe se e njëjta nuk është kompensuar për shpenzimet e ushqimit në punë-shujtat ditore andaj aprovohet pjesërisht e bazuar kërkesëpadija dhe atë bazuar në nenin 54 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Gjykata e Apelit, pas shqyrtimit të këtij propozimi dhe provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka gjetur se nuk ekziston asnjë shkak i paraparë me nenin 232 të LPK-së, për lejimin e këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik, me të cilin kundërshtohet aktgjykimi i formës së prerë.

Sipas pretendimeve të të paditurës propozimi për përsëritjen e procedurës është bërë ngase pas aktgjykimit të formës së prerë, gjegjësisht më 18.10.2021, Gjykata e Apelit e Kosovës, me qëllim të harmonizimit të praktikës gjyqësore, me shumicë votash arriti në përfundimin se marrëveshja e përgjithshme kolektive ka qenë në fuqi deri më 31.12.2017 dhe se nuk mund të jetë zbatuar pas kësaj datë. Andaj nëse ky konkluzion do të kishte ekzistuar në kohën e zhvillimit të procedurës para gjykatës së shkallës së parë dhe nëse e paditura do të kishte mundur të përdorte të njëjtin epilog gjyqësor, do të kishte qenë krejtësisht ndryshe, pra më i favorshëm për të paditurën, pasi që baza ligjore për miratimin e pjesëshëm të kërkesëpadisë së paditësit ka qenë pikërisht kontrata e përgjithshme kolektive, prandaj plotësohen kushtet nga neni 232 pika g) për përsëritjen e procedurës.

Sipas zgjedhjeve ligjore shkaqet për përsëritjen e procedurës janë parashikuar në nenin 232 nga pika a) deri në pikën g) të LPK-së, ndërsa në këtë çështje nuk ekzistojnë asnjëra nga arsyet për përsëritjen e procedurës të parapara me nenin 232 të LPK-së, kjo për faktin se arsyet e dhëna si në propozimin për përsëritjen e procedurës, të parashtruar nga propozuesi nuk përbejnë shkaqe dhe referenca ligjore që procedura në këtë çështje të përsëritet. Sipas dispozitës së nenit 232 pika g) të LPK-së, pala mund të paraqet propozimin nëse vihet në dijeni për faktet e reja ose i gjen provat e reja, që sikur ti dinte këto fakte ose ti kishte parashtruar këto prova në procedurën e parë do të nxjerrët një vendim më i favorshëm. Nga arsyet e parashtruara si në propozimin për përsëritjen e procedurës pala propozuese përmend faktin se nga mbledhja e kolegjiut të gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit ka rezultuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive ka qenë në fuqi deri më 31.12.2017 dhe se nuk mund të jetë zbatuar pas kësaj date dhe nëse ky konkluzion do të kishte ekzistuar në kohën e zhvillimit të procedurës para gjykatës së shkallës së parë, dhe nëse e paditura do të kishte mundur të përdorte të njëjtin, epilogu gjyqësor do të kishte qenë krejtësisht ndryshe, pra më i favorshëm për të paditurën, pasi që baza ligjore për miratimin e pjesshëm të kërkesëpadisë së paditësit ka qenë pikërisht marrëveshja e përgjithshme kolektive.

Lidhur me këto pretendime gjyqtari i vetëm i Gjykatës së Apelit gjen se, është standard i së drejtës që ligji material do të vlejë në kohë të caktuar dhe në territor të caktuar. Në shkresat e lëndës gjendet Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e lidhur me datë 18.03.2014 dhe e nënshkruar nga Organizatat e punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të punësuarve (bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës), si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale). Në nenin 82 të Marrëveshjes është parashikuar që kjo të hyjë në zbatim nga data 01.01.2015. Në nenin 90 par.4 të Ligjit të Punës është parashikuar që: “marrëveshja e Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”. Çështja e kohëzgjatjes së zbatimit të kësaj marrëveshje përbën **fakt notor** dhe nuk përbën ndonjë fakt të ri i cili nuk ka qenë i njohur në kohën kur është vendosur lidhur me kërkesëpadinë e paditësit. Në këtë pikë, pala e paditur (tani parashtruese e propozimit për përsëritjen e procedurës), ka pasur mundësi që këtë prapësim materialo-juridik ta parashtroj me rastin e ndërmarrjes së veprimeve të të paditurit për mbrojtje nga padia e deri në përfundim të procedurës së zhvilluar kontestimore.

Andaj, në bazë të dispozitave të cituara dhe në bazë të rrethanave të prezantuara në propozimin për përsëritje të procedurës, Gjykata e Apelit vlerëson se rrethanat dhe faktet e paraqitura me propozimin për përsëritje të procedurës nuk përbëjnë shkak që të lejohet përsëritja e procedurës.

Gjykata e Apelit, për arsyet e paraqitura si më lart, në kuptim të dispozitës së nenit 15.1 dhe nenit 235 lidhur me nenin 239.1 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË,
CN.nr.23/2022, datë 25.03.2025

Gjyqtari,

Ardian Ajvazi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë (kolegjit prej 3 gjyqtarëve) e përmes po kësaj gjykate, në kuptim të nenit 240.4 të LPK-së.